



AR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 2301/prot.
2Tiranë, më 21 05.2024

URDHËR

Nr. 42 datë 21.05.2024

PËR

MIRATIMIN E MANUALIT INFORMUES PËR PROCEDURAT E RIVLERËSIMIT TË TESTIT,
MSH 2024

Në mbështetje të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, të Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.661, datë 01.12.2023, "Për miratimin e Rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë", si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.27, datë 12.12.2023, "Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2024"


URDHËROJ:

1. Miratimin e manualit informues për procedurat e rivlerësimit të testit, MSH 2024, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet arsimore.

Ky Urdhër-hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aurora BALIU



MANUAL INFORMUES PËR PROCEDURAT E RIVLERËSIMIT TË TESTIT

KREU I

PROCEDURAT QË LIDHEN ME MATURANTIN

1. Maturanti/kandidati ka të drejtë të kërkojë kopjen e testit një ditë pas shpalljes së rezultateve paraprake të të gjitha provimeve të MSH. Pra, vetëm pas shpalljes së rezultateve të të gjitha provimeve, maturanti/kandidati bën kërkesën për kopje të testit nëpërmjet portalit e-albania.
2. Çdo maturant/kandidat që kërkon kopjen e testit duhet të kryejë aplikimin online në portalin e-albania, duke përdorur shërbimin “Kërkesë për kopje të testit të Maturës”, sipas afateve të përcaktuara nga QSHA, për të gjitha provimet e MSH.
3. Pas trajtimit të kërkesës, QSHA do të nisë kopjen e testit për secilin maturant/kandidat që e ka kërkuar atë, në “Hapësira ime”, seksioni “Dokumentet e mia”, në llogarinë përkatëse të çdo maturanti/kandidati, në e-albania.
4. Maturanti/kandidati, pasi është pajisur me fotokopjen e testit ka të drejtë ta paraqesë kërkesën për rivlerësim testi, në KSHMSH e shkollës ku është regjistruar si maturant, **më datë 5 korrik 2024**. Kërkesa për rivlerësim paraqitet sipas **modelit në shtojcën nr.1**, bashkëlidhur këtij manuali.

KREU II

PROCEDURAT QË LIDHEN ME KSHMSH NË SHKOLLË DHE MËSUESIT E SHKOLLËS

1. KSHMSH mbledh të gjitha kërkesat për rivlerësim testi, të paraqitura nga maturantët/kandidatët. KSHMSH administron të gjithë procedurën.
2. Fotokopjet e testeve të paraqitura në KSHMSH shqyrtohen nga dy mësues lëndorë të përcaktuar nga KSHMSH (nëse një shkollë nuk ka dy mësues të lëndës shqyrtimi do bëhet vetëm nga një mësues i lëndës).
3. Mësuesit shqyrtojnë kërkesat e paraqitura nga maturantët/kandidatët vetëm për pyetjet e ankimuara dhe vendosin nëse këto teste do t'i kalojnë për rivlerësim QSHA. Shqyrtimi i kërkesave të paraqitura nga maturantët/kandidatët, vetëm për pyetjet e ankimuara paraqitet sipas **modelit në shtojcën nr.2**, bashkëlidhur këtij manuali.
4. KSHMSH kërkesat për rivlerësim të miratuara nga mësuesit lëndorë, i përcjell në ZVAP në format elektronik brenda datës **5 korrik 2024** dhe në format shkresor brenda datës **6 korrik 2024**, sipas **modelit në shtojcën nr.3** bashkëlidhur këtij manuali.

KREU III

PROCEDURAT QË LIDHEN ME KMSH NË ZVAP

KMSH në ZVAP, kërkesat e paraqitura nga KSHMSH-të i përcjell në format elektronik në QSHA brenda datës **5 korrik 2024**, si dhe zyrtarisht në formë shkresore brenda datës **7 korrik 2024**, sipas **modelit në shtojcën nr.4**, bashkëlidhur këtij manuali.

KREU IV

PROCEDURAT QË LIDHEN ME QSHA

1. QSHA kryen procedurën e rivlerësimit të testeve, me të njëjtat rregulla e procedura si vlerësimi i testeve, duke i sekretuar me barkode testet që rivlerësohen.
2. QSHA kryen rivlerësimin e të gjithë testit. Pas rivlerësimit, vlerësimi përfundimtar i maturantit mund të jetë:
 - a) me të njëjtin rezultat;
 - b) duke iu ndryshuar rezultati me rritje pikësh;
 - c) duke iu ndryshuar rezultati me ulje pikësh;
3. Rezultatet përfundimtare të provimeve të maturës pas procesit të rivlerësimit shpallen jo më vonë se data **10 korrik 2024**.

Shtojca nr. 2: Model i shqyrtimit të kërkesave të paraqitura nga maturantët/kandidatët, vetëm për pyetjet e ankimuar:

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR RIVLERËSIM TË PARAQITURA NGA
MATURANTËT/KANDIDATËT**

Mësuesit lëndorë Z/Znj. _____, Z/Znj. _____,
të përcaktuar nga KSHMSH e shkollës _____, u mbledhën sot më datë
____.____.2024, për të shqyrtuar kërkesat e paraqitura nga maturantët/kandidatët sa më poshtë:

Kërkesë e paraqitur nga maturanti/kandidati: _____

Provimi (Lënda) që ankimon: _____

Arsyetimi i vendimmarrjes nga mësuesit lëndorë

Për pyetjen ____ pretendimi i nxënësit *qëndron* ☐ *nuk qëndron* ☐ sepse: (Vendos (✓) në një nga kutizat.)

____ Për pyetjen ____ pretendimi i nxënësit *qëndron* ☐ *nuk qëndron* ☐ sepse: (Vendos (✓) në një nga kutizat.)

Për pyetjen ____ pretendimi i nxënësit *qëndron* ☐ *nuk qëndron* ☐ sepse: (Vendos (✓) në një nga kutizat.)

Për sa më sipër: (Vendos (✓) në një nga kutizat.)

Kërkesa e maturantit/kandidatit për rivlerësim testi **të përcillet** në QSHA. ☐

Kërkesa e maturantit/kandidatit për rivlerësim testi **të mos përcillet** në QSHA. ☐

MËSUESIT LËNDORË

Z/Znj. _____ (Emër, Mbiemër, Firmë)

Z/Znj. _____ (Emër, Mbiemër, Firmë)

Shtojca nr. 3: Modeli i kërkesave për rivlerësim, të miratuar nga mësuesit lëndorë, plotësuar nga KSHMSH:

[illegible]

1

[illegible]